



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E OBILIQIT-OPŠTINA OBILIĆ
DREJTORIA E ADMINISTRATËS PËRGJITHSHME
UPRAVA OPŠTE ADMINISTRACIJE



Dalës-Izlazna

Nr. 1-114
Br.

Data 23.08.2023
Datum

OBILIQ-OBILIĆ



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E OBILIQIT
OPŠTINA OBILIĆ - MUNICIPALITY OF OBILIC

KUVENDI KOMUNAL OBILIQ

Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obiliq

EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

Nga mbledhja e Kuvendit komunal, të mbajtur me dt.28.07.2023, në orën 11:00, në sallën e Kuvendit komunal.

Të pranishëm ishin këta anëtarë:Vlora Mjekiqi Kabashi, Enver Gashi (IQO), Shaip Paloja (IQO), Labinot Mirena (IQO), Jeton Mjekiqi (IQO), Nazlije Shala (IQO), Florije Jashari (IQO), Lulzim Preniqi (IQO), Fidan Ahmeti, (IQO), Ajshe Haliti Pllana (LVV), Albanë Shillova Shalaku (LVV), Valon Svirca (LVV), Ajet Berisha (LB), Valbonë Beka (LB), Linda Sadiku Krasniqi (LDK), Bajram Hashani (LDK), Xhelal Krasniqi (AAK), Samire Berisha (PDK), Ratomir Ristic (SL) dhe Biljana Spasic(SL).

Të pranishmit tjerë:Xhafer Gashi, Kryetar i Komunës, drejtorët komunal, Festina Preniqi, zyrtare për marrëdhënie me publikun, Burim Gërguri, shef i kabinetit të Kryetarit, dhe Arta Mjeku, zyrtare për kthim të qëndrueshëm

Mbledhjen e udhëhoqi Vlora Mjekiqi Kabashi, kryesuese e cilapasi konstatoi se ka kuorum filloi mbledhjen me këtë:

R E N D D I T E

1. Arsytimi për mungesë
2. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar
3. Shqyrtimi i Raportit të Auditorit të përgjithshëm për vitin 2022
4. Plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve nga ZKA-ja
5. Rishikimi i buxhetit për vitin 2023
6. Shqyrtimi i Raportit gjashtëmuor (6) të punës së DEFZH-së, për vitin 2023
7. Raporti gjashtëmuor (6) i punës së Kryetarit të Komunës dhe Ekzekutivit për vitin 2023
8. Shqyrtimi i kërkesës së DPUKP-së, për plotësimin dhe ndryshimin e vendimit nr.-I-99, të dt.30.10.2017
9. Shqyrtimi i kërkesave
10. Të ndryshme

Kryesuesja– I njoftoi të pranishmit me rendin e ditës dhe propozoi që të shtohet një pikë në rendin editës, në pikën 9 të jetë:“Shqyrtimi i raportit mbi pronat komunale”.

Miratohet rendi i ditës me 19 vota për me ndryshimin dhe potësimin e cekur më lartë.

Pika 1 e rendit të ditës

Mungoi: Sami Ahmeti

Pika 2 e rendit të ditës

Miratohet ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja e kaluar me 19 vota për.

Pika e 3 e rendit të ditës

Enver Gashi - Shpjegoi se Raporti i Auditorit të përgjithshëm është parë dhe është lexu me vëmendje dhe të gjeturat e auditorit janë zotu se të gjitha do të përmisohen.

Valon Svirca - Raporti i auditimit ka konfirmuar paralajmërimet e Lëvizjes Vetëvendosje, qendra në Obiliq për keqpërdorimin e parasë publike dhe detyrës zyrtare në Komunën e Obiliqit. Raporti i auditimit për vitin 2022 ka rezultuar me 15 rekomandime të cilat janë konstatime të keqpërdorimeve nga zyrtarët lokal. Gjatë auditimit janë vërejtur parregullësi në shumë fusha, dy nga to janë: tejkalimi i kontratës kornizë, Komuna e Obiliqit me datë 20.10.2020, kishte lidhur kontratë kornizë në vlerë prej 96.505 euro me titull "Pastrimi i mbeturinave ilegale". Gjetjet e auditorit kanë zbuluar se vlera e kësaj kontrate është tejkalu për 271.258 euro, pra më shumë se 150 %, e vlerës së parashikuar. Operatori ekonomik që përfitoi nga kjo kontratë është vjehri i drejtoreshës së Drejtorisë për mbrojtje të mjedisit. I njëjti operator ka fituar një kontratë të këtij viti, në janar 2023 me vlerë 267.000 euro. Subvencionimi pa thirrje publike është shkëlja tjetër e konstatuar nga raporti i auditimit të Obiliqit. Me pak fjalë Kryetari i Komunës jepë subvencione veç kujt të don nga taksat e qytetarëve. Te subvencionet pa thirrje publike, në rastin e Kuvendit Komunal ka ekzekutuar një shumë prej 30.000 euro, një OJQ të cilët kishin detyrime tatimore ndaj ATK-së, dhe si pasojë e këtyre borgjeve është ekzekutu veç 27.717 euro, edhe kjo një shkëlje tjetër.

Kryesuesja - Deri në fund të auditimit 6 rekomandime veç janë zbatu aty për aty, 5 deri më tash veç i kanë plotësu dhe 1 ka qenë pjesërisht që besoj se Ekzekutivi veç i ka zbatu.

Ajet Berisha - Shkeljet dhe rekomandimet kanë rezultu me 15 rekomandime, për shmangie të procedurës dhe për elemente tjera, që nuk janë në harmoni me funksionimin normal, përveç tek auditori i brendshëm që nuk kemi raporte asnjëherë. Pra, është vërejtje e përveçshme dhe zotim i përhershëm i Komunës, që do të krijohet njëسيا e auditimit edhe raporte nuk kemi asnjëherë nga auditori i brendshëm. Të gjitha të tjerat, nuk është mungesë e kapaciteteve njerëzore, nuk është mungesë e dijës që është lëshu ai gabim. Këto gjetje janë bërë me qëllim e që përgjegjës për mbikqyrje është drejtëpërdrejtë Kryetari edhe auditori e përcakton. Krejt këto me qëllim në rast se janë bërë nga njësitë varëse të Kryetarit, Kryetari është dashtë me marrë masa ndaj atyre, që i kanë bë këto shkëlje. Në rast se ky ka diktat që ato me ndodhë atëherë ndaj kujt me marrë masa vetëm këta deshta me cekë që të gjitha këto as nuk janë për shkak të mungesës së kapaciteteve, që ka kjo Komunë, as nuk janë për shkak të mosdijës të sektorëve të caktuar. Tani, pse ka ndodh ajo shkëlje mendoj se kjo ka ndodhë me rekomandim të Kryetarit që me ndodhë ato çfarë kanë ndodhë.

Kryetari - Unë jam i lumtur që për 10 vite, Komuna jonë nuk e ka raportin e auditimit të modifikuar, nuk ka të cekura çështje të theksuara. Gabimet teknike ndodhin gjatë punës që janë rekomandime me të cilat patjetër ne duhemi të merremi me ato dhe ti përmisojmë. Parafolësi e luajti rolin e viktimës duke qenë edhe ky dikur ushtrues apo edhe Nënkryetar dhe e din që Kryetari e as Nënkryetari nuk i ndanë subvencionet, por i ndajnë Komisionet. Ai ka në këtë rast edhe menaxher të projekteve tatimore, por ndoshta i ka harru që nuk është dashtë me harru sepse është delegat të paktën më shumë se 12-13 vite, është pjesë e institucioneve komunale e mundohet në cilësinë e viktimës me e prezentu dëmin. Mirëpo, prapë po e potencoj se e kemi edhe planin e veprimit dhe do të bëjmë përpjekje maksimale që të gjitha problemet ti zvogëlojmë me qëllim të funksionimit sa më mirë të Komunës.

Pika 4 e rendit të ditës

Kryesuesja – Ju, Planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve, e keni marrë ku vetë auditorët këtu e kanë potencu se deri në fund të auditimit tonë për vitin 2022, 6 rekomandime janë zbatu, 5 nuk janë adresuar. Unë po flas për atë kohë që besoj se tani janë në rregull sepse është edhe plani dhe 1 është pjesërisht.

Enver Gashi - Ky plan i veprimit është një zotim i Ekzekutivit, që të gjitha rekomandimet e auditorit të zbatohen gjithë që edhe gjatë periudhës së auditimit vetëm 6 pika janë përfundu dhe uroj që edhe pikat tjera të kryhen.

Pika e 5 e rendit të ditës

Kryesuesja – Paraqet kërkesën për rishikim të buxhetit nga DEFZH-ja, projektte kapitale dhe nga mbetja e vlerave të pa shpenzuar sipas nenit 16 të Ligjit mbi financat publike dhe përgjegjësitë, mjetet mund të alokohen vetëm në projektet kapitale të listuara në tabelën 4.2 të OB-së me 14.99 %, dhe mjetet e rishikuara kalojnë në dy projekte që janë kryer punimet.

Enver Gashi – Mendoj se është një dukuri e mirë që po bëhet një rishikim i mjeteve të cilat kanë tepru nga projektet kapitale, që do të thotë se ato veç kanë përfunduar dhe tash pjesa tjetër të investohet në projekte të tjera, të cilat janë me prioritet. I lumtë Ekzekutivit, që vetëm në këtë 6 muaj ka të kryera shumë projekte .

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal e aprovuan Vendimin për rishikimin e buxhetit për vitin 2023 me 13 vota për dhe 5 vota absetim.

Pika e 6 e rendit të ditës

Kryesuesja - Paraqet shqyrtimin e raportit 6 muajor të punës së DEFZH-së, për vitin 2023.dhe tha se është raporti i shpenzimeve, raporti i tatimit në pronë dhe raporti i ekonomisë.

Enver Gashi - Ky raport i DEFZH-së, është raport i rregullt i 6 muajorit të parë dhe është me rëndësi të ceket se është raport i ardhur me kohë. Ne nuk kemi ndonjë vërejtje.

Ajet Berisha - Është prej herave të rralla, që në thelb më i rëndësishëm është raporti për ekonomi dhe financa dhe është prej të rrallave herë që Komuna shpenzon sasi të madhe të mjeteve, për një periudhë kaq të shkurtë 6 mujore. Ju përgëzoj për këtë punë pavarësisht arsyeja qysh ka ardhë dmth kjo e bënë Komunën, me kuptu që jo gjithmonë duhet me shku me projekte afatëshkurta, por me mendu edhe projekte afatgjate që ke mundësi me shpenzu buxhetin, e jo me të mbetë suficit prandaj e përgëzojë Komunën për këtë shpenzim.

Pika e 7 e rendit të ditës

Kryesuesja - Paraqet kërkesën me nr.II, e datës 18.07.2023, raportin e punës së Kryetarit dhe Ekzekutivit janar-qershor 2023. Raportin e gjeni të ndarë në 3 pjesë, raporti i punës së Kryetarit dhe i Ekzekutivit janar-qershor 2023, raporti financiar dhe raporti i zyrës së Prokurimit 6 muajor.

Enver Gashi - Ne nuk kemi ndonjë vërejtje në këtë raport të punës vetëm një lëvdatë për punën dhe sukseset e ardhshme.

Pika e 8 e rendit të ditës

Kryesuesja – Paraqet kërkesën e DPUKP-së, për plotësim ndryshim e vendimit nr.-I-99, të dt. 30.10.2017.

Enver Gashi - Ne në Komitet për Politikë dhe financa u dakorduam që ky ndryshim të bëhet prej 9 viteve në 8 vite.

Valon Svirca - Edhe ne jemi për ndryshimin prej 9 viteve në 8.

Kryesuesja- Të nderuar anëtarë të Kuvendit Komunal, kush është për që të bëhet plotësim ndryshimi i vendimit nr.-1-99 i datës 30.10.2017 saktësisht në nenin 2 rendi 8 dhe neni 9 ku nga periudha 9 vjeçare zëvendësohet në periudhën 8 vjeçare.

Anëtarët e Kuvendit komunal me 19 vota për e aprovuan Vendimin për plotësim ndryshimin e vendimit nr.-I-99, të dt.30.10.2017.

Pika 9 e rendit të ditës

Kryesuesja – Paraqet shqyrtimin e raportit mbi pronat komunale

Enver Gashi – Ky është një raport i rregullt, është një raport me kohë i 6 muajorit të parë dhe këtu shihet që është një transparencë e plotë për pronat të cilat komuna i ka dhënë, Ne nuk kemi ndonjë vërejtje të madhe megjithëse, vërejtja më e madhe është zotimi i kryerjes së infrastrukturës nga Komuna dhe Qqeveria që ka mbetë pa u shtruar rruga. Komuna i ka kry obligimet e veta, trasen me zhavor e caktimin e trasës në komplet rrugën, mirëpo ka vërejtje që operatorët nuk mundën me i krye punët për shkak të infrastrukturës, rrymës edhe të rrugës.

Valoni Svirca - Përafërsisht të njejtat fjalë janë për shkak të infrastrukturës që kanë problem për me u zhvillu edhe bizneset.

Ajet Berisha - Në thelb raporti është raport, pasqyron gjendjen në terren. Fatkeqësisht një numër i kompanive, që kanë marrë prona nuk janë as afër realizimit në bazë të planit dinamik që ata vetë e kanë paraqitë kur ata e kanë marrë pronën. Kjo, është një humbje për Komunën e është dashtë me qenë shqetësim edhe për Kryetarin edhe për Kuvendin, që të gjitha ato kompani apo individë të cilat në pronë komunale kanë zotim 1 vjet, 2 vjet, 3 vjet varësisht planit që ata kanë ofru me i rishqyrtu ato vendime apo me i ofru Kuvendit një zgjidhje për ato të cilat ata kanë bërë vonesa. E dyta, Komuna orët e para të gjitha kushtet që ka thënë që ka me i krye, është dashtë me e marrë përsipër edhe gjithë atë infrastrukturë, që iu duhet të gjitha kompanive për me i realizu punët e veta. Këto prona janë në interes të Komunës, për rritjen e vlerës së tyre dhe me i punësu njerëzit tonë aty. Meqë këto nuk po ndodhin unë po mendoj që Komuna, Kryetari është dashtë me reagu aty, ku nuk po realizohet plani dinamik. E dyta, këto fjalë kanë me qenë gjithmonë në bazë të raportit dhe unë këto fjalë i them edhe publikisht edhe kujt do ju shkoni ja interpretoni po na bon presion Ajeti, e ata le të vijnë tani te unë kushdo qoftë, vllau jem në qoftë në pyetje. Unë i përgëzoj krejtë ato kompani që në bazë të planit dinamik e disa edhe më herët i kanë krye punët dhe e kanë rritë interesin për Komunën. Për krejt ata që kanë ngecë, në rast se jemi fajtor ne si Komunë, është mirë orët e para me i krye punët dhe nese, ata janë fajtorë është dashtë Kryetari me shqyrtu atë plan dinamik me ia ofru edhe një rast asaj kompanie, në rast se ka kapacitete me e pru planin e ri dinamik, jo, jo me shqyrtu komplet kontratën këto fjalë kanë me qenë gjithmonë shko thuajani kujna dush.

Kryetari - Mendoj që të gjitha pronat që janë dhënë për shfrytëzim janë dhënë me të vetmin qëllim që të krijohen mundësi punësimi, por edhe në aspektin e të hyrave vetanake që të ketë ngritje në përgjithësi. Ju e dini të gjithë, që kemi pas marrëveshje me Ministrinë e mjedisit dhe planifikimit hapsinor dhe infrastrukturës sa i përket çështjes së rrugës jemi dakordu edhe e kemi përmbyllë si pjesë procesin e heqjes së humusit. Pastaj trajtimet nëntokësore, gypa e këto që kanë qenë edhe është vendosë zhavorri. Po ashtu, ka qenë obligim i Ministrisë që nuk e ka vazhdu marrëveshjen dhe ne jemi të shqetësuar në këtë drejtim, po bëjmë përpjekje me e përmbyllë si proces qoftë me buxhet komunal apo edhe me donatorë. Në këtë rast Ministria, por edhe donatorë të tjerë, çështja e rrymës është çështje problematike për shkak të KEDS-it, ne ju kemi ofru mundësi edhe nese, do të ketë nevojë me financu për me mund me e përmbyllë si proces sepse është në interes të Komunës tonë. Duke u bazuar në Ligjin për vetëqeverisjen lokale dhe ligjin për dhënien e pronave në shfrytëzim, ne e kemi respektu ligjin e jemi mundue maksimalisht që me qenë sa më shumë transparentë. Nëse, ju kujtohet të gjitha pronat paraprakisht pas negocijimit me kompanitë i kemi ftuar të gjithë asambleistët që të marrin pjesë në një prezentim paraprak para se të vijnë në Kuvend kërkesat për miratim dhe pastaj ju keni vendos sepse delegatët janë ata që e japin pronën në shfrytëzim dhe jo Ekzekutivi. Ne jemi në mbështetje të vazhdueshme dhe në mbikqyrje të realizimit të projektit, por duke e pa pamundësinë siç e dini edhe ju vetë përpjekjet i kemi pasë për planin zhvillimor dhe tani në plan zhvillimor ajo çka na konsiderojmë është diskriminim. Potencohet që ne nuk kemi të drejtë dhënien e kushteve ndërtimore dhe të gjithë ata të cilët kanë apliku jemi obliguar paraprakisht me i njoftu që me e ndërpre aktivitetin deri sa të mbyllet çështja e hartave zonale. Janë disa kompani që i keni parë ju në raport që unë ju kisha propozu meqë, ata nuk kanë fillu asnjë aktivitet qoftë në kërkesa paraprake për kushte ndërtimore, apo edhe për leje nuk e kanë zhvillu asnjë fazë nuk kanë shpreh asnjë interes e nuk kanë pru asnjë kërkesë për shtyrje, është e drejtë e juaja që ne ti rikthejmë prapë në pronësi të Komunës, që të ia ofrojmë ndonjë biznesi i cili është i interesuar të investojë.

Ajet Berisha - Edhe një element në raport me këtë që e tha Kryetari, meqë jeni përgjegjës për mbikqyrjen e këtyre kontratave që vërtetë Kuvendi i ka nxjerrë kishte me qenë mirë që ju me ardhë me rekomandite çka me bërë me ata që nuk i realizojnë. Raporti është diçka ligjore që ju duhet me e pru dhe na me shqyrtu, n'ërsa pjesa tjetër është përgjegjësi e juaja, është përgjegjësi e Ekzekutivit për me ardhë me rekomandim sepse këto plane dinamike nuk po zbatohen dhe vendimi nxjerret në Kuvend.

Kryetari - Unë besoj se isha i qartë dhe raportin ju e merrni, që në raporte i keni të dhënat për secilin operatorë, zhvillimet dhe procedurat në të cilat është. Unë mendoj që nuk ka rekomandim më të madh dhe ai i cili nuk e ka nisë asnjë hap për realizimin e projektit të vetë që është zotu është e drejtë e juaja ta riktheni pronën në Komunë shihni të gjitha nëse, i keni shiku me vëmendje dhe për cilin do vendim që ju e merrni, ne jemi me ju.

Pika e 10 e rendit të ditës

Kryesuesja – Paraqet kërkesën me nr.-II-1009 të datës 19.07.2023 nga Kryetari i komunës për plotësim ndryshimin e vendimit të Këshillit komunal për siguri në bashkësi, në vend të znj. Valbonë Beka të jetë z.Naim Shabani.

Anëtarë e Kuvendit komunal me 19 vota për e aprovuan Vendimin për plotësim ndryshimin e vendimit të Këshillit komunal për siguri në bashkësi, në vend të znj.Valbonë Beka të jetë z.Naim Shabani, anëtar.

Pika 11 e rendit të ditës

Kryesuesja – Ju njoftoj se kemi pranuar kërkesë nga Ministria e planifikimit hapsinor dhe infrastrukturë në lidhje me vendimet e marra për emërtimin e rrugëve. Ne me vendim kemi emërtu rr."Jakup Raçi" emërtimin e rr. "Nexhmedin Krasniqi" në Milloshevë dhe rr."Tefik Krasniqi" në fshatin Mazgit. Ministria ka përgjegjen e njejtë për të tri këto vendime lidhur me emërtimet e rrugëve. Ministria e planifikimit hapësinor dhe infrastrukturë pas shqyrtimit të ligjshmërisë kërkon nga Kuvendi i Komunës së Obiliqit, rishqyrtimin e ligjshmërisë së këtyre akteve. Me arsyetimin se emrat e ri duhet të bazohen sipas emrave rezervë në listë sipas nenit 6 pika 1.1.16 të Udhëzimit administrativ për krijimin dhe administrimin e listës alfabetike për emërtime, listës rezervë për vendosjen e tyre në regjistrin komunal të adresave.

Emërat e rrugëve fillimisht duhet të dërgohen në AKK për shqyrtim teknik, pastaj të dërgohen në Kuvend sipas udhëzimit nr.16 /2019 për procedurat e krijimit dhe administrimit të regjistrit shtetërorë të adresave 119 pika 1.3. Mungon skica e formës së rrugëve dhe nuk mund të vlerësohet teknikisht sipas Udhëzimit nr.16 2/019.

Arben Berisha - Ministria plotësisht ka të drejtë dhe për këtë arsye ne edhe kërkojmë falje. Ne jemi bazuar në Ligjin nr 04 – L/71, ligji e specifikon, mirëpo tani e kemi Udhëzimin Administrativ dhe është e vërtetë që unë nuk e kam parë kështu që nuk kam veprue në bazë të Udhëzimeve administrative. Ligji e thotë vendimi për emrat e zonave merret nga Kuvendi komunal në jurudiksionin në të cilin ndodhen ata. Mendoj se duhet me i shfuqizu, vendimet është ngarkesë e madhe, por kemi punë shumë dhe ka rrjedhë gabimi, kërkojmë falje. Sa për sqarim na jena bazuar edhe në praktika të mëhershme, që çdo herë i kemi dërgu na u kanë aprovu vendimet, por është e vërtetë që nuk e kemi lexue Udhëzimin e fundit.

Ajet Berisha - Kam qenë në proces të emërimit të rrugëve që nga fillimi edhe të këtyre adresave dmth Rregullorja edhe ky Udhëzim ka qenë herët. Po ashtu, është e vërtetë që edhe kur kam qenë në Kuvend kam sugjeru që me u zbatu lista rezervë se ne kemi pas 30 % të emërimit të rrugëve, kemi lënë rezervë me emra të cilët nuk janë zbatu asnjëherë. Andaj tash ka fillu se Ministria si ka shikue shumë herë e i ka aprovu në momentin që i shikon ta kthen sepse ti e ke një listë rezervë, e ke me përditsëu për çdo vitë. Mirëpo, asnjëherë nuk e bëjmë vetëm kur vjen kërkesa e një rruge edhe ajo a i plotëson kriteret përpara ka qenë minimalisht 100 m rrugë dhe 10 shtëpi aty, për me u quaj të rrugë ndryshe nuk mundet me u emëru. Ne kemi probleme se nuk i shikojmë dokumentet, as nuk i faktojmë vendimet, që i nxjerrim vetë dhe dalin këso telashe.

Arben Berisha - Për shkak të opinionit më duhet të flasë se parafolësi ka tendenca dhe është tendencioz në çdo kuptim. Në të vërtetë nuk duhen 10 shtëpi, por 5 deri në 10 shtëpi dhe lista rezervë nuk është as bibël e as kuran sepse ligji e jepë mundësinë me e rifresku çdo vit. Unë e potencova shumë mirë, por nuk është e vërtetë që Ministria nuk i shikon këto lëndë, i ka shikue, por Udhëzimi ka ardhë me vonesë dhe aty ku është ardhë aty i kanë ndalë.

Kryesuesja - Të nderuar anëtarë të kuvendit kush është që të shfuqizohet vendimi me nr.-I- 87, i dt. 30.06.2023 për emërtimin e rrugës me emrin "Jakup Raçi" në fshatin Mazgit.

Anëtarët e Kuvendit Komunal me 13 për dhe 4 vota abstenim morën Vendim për shfuqizimin e vendimit nr.-I-87, të dt.30.06.2023.

Kryesuesja – Paraqet kërkesën për shfuqizim të vendimit nr. –I-88 të dt.30.06.2023, për emërtimin e rrugës me emrin "Nexhmedin Krasniqi" në fshatin Milloshevë.

Anëtarët e Kuvendiut Komunal me 13 për dhe 5 vota abstenim morën Vendim për Shfuqizim të vendimit nr.-I-88, të dt.30.06.2023.abstenim.

Kryesuesja – Paraqet kërkesën për shfuqizim të vendimit nr.- I-89, të dt. 30.06.2023 për emërtimin e rrugës me emrin "Tefik Krasniqi" në fshatin Mazgit.

Anëtarët e Kuvendit Komunal me 13 vota për dhe 5 vota abstenim e shfuqizuan Vendimin nr.-I-89, t ë dt.30.06.2023.

Pika 12 e rendit të ditës

Kryesuesja - I kemi disa përgjigjeje që z.Ahmeti i ka kërkuar në KPF, konkretisht ka kërkuar që nëse, ka pëlqim për një strehimore të qenve në Bakshi dhe kemi përgjigjeje nga drejtori i bujqësisë z.Bejtullah Mjekiqi, se Drejtoria për Bujqësi dhe zhvillim rural nuk ka lëshu as pëlqim, e as leje për strehimore të qenve endacak. Po ashtu, kemi për të njejtën pyetje përgjegje nga drejtori i inspektionit z.Naim Miftari, për strehimore të qenve endacak në Bakshi. Drejtoria e inspektionit ka hartuar procesverbal inspektues me nr.105000142 për OJQ-në Organizata kujdesin dhe shpëtimin e kafshëve, e cila është në bashkëpunim me OJQ-në nga Gjermania. Organizata për kujdesin dhe shpëtimin e kafshve është në procedurë për pëlqim në Agjensionin për ushqim dhe Veterinari dhe Drejtoria e inspektionit zyrtarisht e ka kundërshtuar Agjensionin për ushqim dhe veterinari dhënie e pëlqimit për zhvillim të veprimtarisë të kësaj OJQ-je, në këtë lokacion me ç'rast janë cekur disa arsye pse kjo OJQ, nuk duhet të pajiset me pëlqim. Drejtoria e inspektionit është në pritje të marrjes së vendimit nga ana e Agjensionit për ushqim dhe veterinari dhe duhet të marrë hapa konkret ligjor lidhur me veprimet e drejtorisë së inspektionit do të mbeten të njoftua. Nëse z. Sami Ahmeti dëshiron me marrë përgjegjen edhe me shkrim është e drejtë e tij. Po ashtu, kemi nga DSHPE-ja, drejtori Abdylrahman Krasniqi përgjegje për pyetjen e z.Sami Ahmeti, në lidhje me dritat që nuk po punojnë dritat, apo nuk po ndërrohen dritat në lagje të ndryshme të Komunës së Obiliqit. Duke u bazuar në kërkesën në lidhje me ndriçimin publik ne si Drejtori e shërbimeve publike dhe emergjente ju njoftojmë se me datën 25.11.2022 kemi lehtësuar procedurat për lidhje të kontratës për mirëmbajtje të ndriçimit publik, hapja e tenderit është bërë me datën 08.12.2022, shpallja e fituesit është bërë me datën 28.12.2022, me datë 04.01.2023 është nxjerrë vendim mbi pezullimin e aktivitetit të Prokurimit për arsye se ka pasë ankesë nga operatori ekonomik. Pas kësaj është nxjerrë vendim me kërkesë për shqyrtim nga autoriteti

kontraktues dhe operatori nuk pajtohet me vendimin e autoritetit kontraktues dhe lënda shkon në OSHP. Vendimi i OSHP-së, është kthyer me datën 08.05 dhe nga janari 2023 kthen lëndën në rivlerësim dhe vendimi për shpalljen e fituesit bëhet me datë 07.06.2023. Me datë 13.06.2023, autoriteti kontraktues merr vendim për pezullim të aktivitetit pas pranimit të ankesës të operatorit ekonomik. Me datë 05.07.2023 autoriteti kontraktues merr vendim për anulim të procesit të Prokurimit dhe me datë 25.07.2023 merr vendim për anulim të tërësishëm të procedurës, pasi që nuk ka pas ankesa nga operatori ekonomik. Procedura e re fillon pas 10 dite, dhe kjo është përgjigjeje e dritave sepse edhe znj.Valbonë ka bë disa herë pyetje në lidhje me këtë çështje. Sa i përket Ansambilit të qytetit, kemi përgjigjeje nga drejtoresha e kulturës Arba Mirena. Ansambli i qytetit është në procedurë, veprimtaria e Ansambilit është ende si OJQ kulturore AKV- qyteti i Obiliqit për faktin se është në procedura miratimi i ligjit për artin dhe kulturën, i cili momentalisht ndodhet në Kuvendin e Kosovës. Pas miratimit do të procedojmë tutje, sipas ligjeve njëkohësisht ju njoftojmë se Komuna e Obiliqit, ka përfunduar të gjitha procedurat në domenin e përgjegjësive të saj si institucion për themelimin e Ansambilit të qytetit si dhe ka realizuar takime të vazhdueshme me akterët brenda MKRS-së, për procedurat e mëtutjeshme për funksionalizimin e Ansambilit.

Valon Svirca - Edhe më heret e kemi ngritë një shqetësim për varrezat në fshatin Mazgit, Kryetar edhe nëse ka pronë aty afër të Komunës me bë një zgjidhje sepse është kogja problem. Krejtë óka mundemi me bë ne është se mundemi me organizu një takim me bashkëfshatarë, që me mund me gjetë një zgjidhje. Mendoj se kishte me qenë edhe më e favorshme edhe për qytetarë që Komuna me gjetë një mundësi më të mirë. Tesubvencionimi i klubeve të OJQ-së, deshta me pyet drejtoreshën a janë respektue krejt kriteret sepse nëse kanë obligime ATK-ja, mund me ndodhë për me ia ndalë mjetet edhe anëtarët e Komisionit, që e kanë bërë vlerësimin e aplikuesve të OJQ-së.

Ajshe Haliti Pllana - Me që rruga kryesore e Obiliqit është vazhdu unë deshta me pyet për dy rrugë që kanë mbetë tash rruga te Kedsi dhe rruga te Xhamia, kur kanë me u rregullu ato dy rrugë edhe me u bë zgjerimi i tyre sado pak pasi që në ato rrugë po ka shumë probleme sepse dy vetura nuk i nxen edhe gjithmonë ka konflikte. Qytetarët nuk po munden me u pajtu me ato rrugë edhe gjendja e tyre është shumë e keqe dhe ngushtimi, dmth kur pritët me u rregullu dhe me u zgjeru aq sa ka mundësi ato dy rrugë, që kanë mbetë rrugë zëvendësuese të rrugës kryesore.

Valbonë Beka - Unë kam një pyetje dhe ndoshta, nuk kam informatë të saktë, por për këtë shkak po e bëjë pytjen. Kam informatë se pjesa para banesave të Hadës, ka me u bë parking nëse, është e vërtetë unë mundem me shpreh atë paknaqësinë dhe jam kundër asaj. Nuk e di sa kam të drejtë mirëpo edhe ajo pak hapësirë gjelbëruese edhe pjesa ku luajnë fëmijaët është një fushë sportive shumë e vogël ku e zhvillojnë aktivitetin fëmijët, por ju mohohet ajo e drejtë.

Samire Berisha - Unë e kam një kërkesë dhe kërkesa ime i drejtohet Drejtorisë së Arsimit, siç e dimë për nevojat shkollore si të mësimdhënësve, aashtu edhe të nxënësve nevojitet qasja në internet. Kjo ju ndihmon që nxënësit të hulumtojnë dhe mësimdhënësit të shfrytëzojnë burime nga interneti. Kërkesa ime i drejtohet Drejtorisë të Arsimit, që sipas mundësive të sigurojë shtrirjen e internetit nëpër shkolla të Komunës tonë, përkatësisht në shkollën "Ibrahim Rugova" në fshatin Mazgit i Epërm. Shpresoj që kjo kërkesë të marrë një përgjegje pozitive.

Labinot Mirena- Duke e marrë parasysh ndihmën e madhe që Komuna ua jepë studentëve tonë, ndihmën e vazhdueshme financiare gjatë studimeve duke lehtësuar dukshëm barrën e familjes, gjë e cila ua mundësonë edhe studentëve një mirëqenie dhe lehtësim gjatë studimeve, kërkojmë nga Kryetari dhe Drejtoria e Arsimit që në skemën e përkrahjes për studen ë të përfshihen edhe studentët të cilët vijnë studimet jashtë Kosovës, siç është universiteti i Tetovës, që ka pak studentë të Obiliqit që i vijnë studimet atje. Viti kushton diku afër 5.000 euro, është mirë që me ju dalë në ndihmë dmth 1.500 euro nëse, ka mundësi për ata studentë që nuk kanë pas mundësi me i viju studimet në universitetin e Prishtinës në studime mjekësore me iu nda një shumë 1.500 euro. Psh prej mjekësisë që e kemi doktoreshën Ajeten, është mirë atyre studentëve që janë atje me ua bë një zgjidhje 1.500 euro në vit, për shpenzimet jashtë mase që i kanë të mëdha.

Kryetari - Po e fillojë prej pyetjes së parë, sinqerisht është shqetësuese se veç është përmbyll dhe ne e kemi diskutuar disa herë që mendoj është rast urgjentë me e thirrë një mbledhje me Kryetarin e fshatit edhe bashkëfshatarët në atë zonë me u përcaktu për lokacion. Komuna është e gatshme edhe nëse, duhet me e shpronësu ndonjë zonë i përshtatët fshatit me qëllim që të krijojmë hapësirë shtesë, kurdo që e vlerësoni ne jemi të gatshëm, ose e organizoni ju, ose edhe na e kërkojmë përmes administratës që të kërkon nga Kryetari i fshatit pastaj ju informojmë. Te vlerësimi i subvencioneve, do të bëjmë përpjekje maksimale dhe unë me sa e di asnjë OJQ apo individë nuk përfiton nëse, nuk i plotëson kushtet. Të gjithë përfituesit e viteve paraprake janë të obliguar me i sjellë edhe raportet e shpenzimeve edhe nëse, nuk gaboj çdo operatorë që përfiton më shumë se 10.000 euro gjatë vitit nuk nënkupton vetëm prej Komunës, por që ka edhe qarkullim, është i obliguar me sjellë raport të auditimit të brendshëm. Tek rrugët, te Xhamija dhe te Kedsi, te Xhamija është shpallë, por ka pas probleme në paramasa dhe është anulë tenderi, është projekt i përbashkët me Demosin, që e kemi përfitu edhe besoj që tash e kanë rishpallë prokurimi. Shumë shpejt, prej pjesës të kubëzave do të trajtohet edhe pjesa nëntokësore, trajtimi i ujrave atmosferike e pastaj rruga dhe jo me ia marrë, por me mund me shtu hapësirën gjelbëruese. Pastaj, edhe pjesa e poshtme do të trajtohet me ujëra të zeza edhe ujërat atmosferike dhe besoj që do të përmbillet si projekt,

pastaj është projekti tjetër që ka për qëllim plotësimin e këndit të lojrave të fëmijëve dhe aty do të ketë mundësi për mbjellje të drunjëve. Për shkollat ne kemi fillu me bë digjitalizimin në Komunën tonë, pothuajse në krejtë objektet institucionale do të ketë digjitalizim dhe mbikqyrje të kamerave. Ne jemi në proces me siguri e keni pa edhe pjesën e parë buxhetore, e kemi nda kogja një buxhet të madh për me fillu me i digjitalizu krejtë shkollat me qëllim që me e pasë më të lehtë fëmijët edhe mësime të mësimdhënësit, do të ketë Smart TV, do të ketë kompjuter do të ketë Tabela Elektronike. Për studentët që vijojnë mësimet jashtë vendit me shumë dëshirë nëse, ju vendosni por paraprakisht duhet me sjellë Rregulloren edhe me përcaktu me Rregullore të brendshme, e nëse dëshironi ne mundemi me pru në plotësim ndryshim tjetër Rregullore të subvencionimeve. Mirëpo, edhe në kategori tjera, nëse kem nevojë për plotësim ndryshim ia vlen edhe nëse e vleroni e futim edhe këtë pse jo. Ju e dini që në këtë drejtim kemi qe ë gjithmonë të hapur dhe kemi dëshirë sa më shumë me i ndihmu brezat e ri. Sa i përket parkut te banesat e Hades, nuk ka tendenca me u bë parking.

Mbledhja përfundoi në ora 12:10'

Procesmbajtëse


Suzana Hashani

Kryesuesja e Kuvendit Komunal


Vlora Mjekiqi Kabashi

